



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Mësimdhënies Lëndore

Me datë 11.5.2021

Vendimet për DISKUTIM PUBLIK					
#	Kandidati	Specializimi	Tema e punimit	Komisioni	
1	Abetare Hajredinaj	Mës. Matematikë	Përshtatja e tekstit të matematikës për klasën e shtatë me rezultatet e të nxënit në kurrikulën lëndore për fushën e matematikës	Kryetar/e	Fahri Marevci
				Mentor/e	Eda Vula
				Anetar/e	Vlora Sylaj
2	Filloreta Berisha	Mës. GJLSH	Kurrikula Bërthamë dhe ndikimi i saj te mësimdhënësit e gjuhës shqipe në SHFMU	Kryetar/e	Xhavti Beqiri
				Mentor/e	Naser Pajaziti
				Anetar/e	Agnesa Çanta
3	Melihate Dobra	Mës. Tekn.TIK	Përdorimi i Google Forms për vlerësim tek nxënësit e klasës së dhjetë	Kryetar/e	Kastriot Buza
				Mentor/e	Kyvetë Shatri
				Anetar/e	Florent Bunjaku
4	Fahri Tershani	Mës. Tekn.TIK	Efektet e përdorimit të mësimi dixhital në motivimin e nxënësve dhe rezultatet e të nxënit	Kryetar/e	Kyvetë Shatri
				Mentor/e	Florent Bunjaku
				Anetar/e	Kastriot Buza
5	Blerina Ibrahim	Mës. Biologji	Përparësitë dhe mangësitë e e-mësimi në lëndën e biologjisë në shkollën e mesme të ulët	Kryetar/e	Kyvetë Shatri
				Mentor/e	Ruzhdi Kuqi
				Anetar/e	Hatixhe Ismajli
6	Yllka Emini	Mës. Tekn.TIK	Efekti i menaxhimit të mësimi përmes platformës Schoology në mësimdhënie dhe mësimnxënie	Kryetar/e	Kyvetë Shatri
				Mentor/e	Sylejman Berisha
				Anetar/e	Kastriot Buza
7	Vildane Sekiraqa	Mës. Matematikë	Analizë krahasuese e prezentimit të konceptit të funksionit në tekstet e vjetra dhe të reja të matematikës për klasat 6 dhe 7	Kryetar/e	Sylejman Berisha
				Mentor/e	Valbona Berisha
				Anetar/e	Jehona Ferizi
8	Leonora Kadriu	Mës. Kimi	Perceptimet e nxënësve për praktikën e vlerësimit në lëndën e kimisë	Kryetar/e	Islam Krasniqi
				Mentor/e	Jehona Ferizi
				Anetar/e	Arlinda Damoni
9	Bjondina Zejnullahu	Mës. Histori	Puna në grupe në funksion të motivimit të nxënësve për të nxënit e lëndës së Historisë në shkollat e mesme të ulta	Kryetar/e	Myrvete Dreshaj
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Florent Bunjaku
10	Elfete Shurdhaj	Mës. Tekn.TIK	Përdorimi i Teknologjisë asistive (ndihmëse) te femijët me nevojat të veçanta në shkencat Matematiko-Natyrore	Kryetar/e	Kastriot Buza
				Mentor/e	Buniamin Mehmedi
				Anetar/e	Naser Zabeli

11	Albanina Ramaj	Mës. Biologji	Ndikimi i metodës bashkëbiseduese në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore nga biologjia	Kryetar/e	Zeqir Veselaj
				Mentor/e	Ruzhdi Kuqi
				Anetar/e	Naser Pajaziti
12	Behare Gashi-Shala	Mës. GJLSH	Mjetet e komunikimit në gjuhë, letërsi, kulturë, folklor dhe art	Kryetar/e	Myrvete Dreshaj
				Mentor/e	Atdhe Hykolli
				Anetar/e	Khavti Beqiri
13	Skender Asllani	Mës. GJLSH	Fusha leksikore dhe mbingarkesa gjuhësore në tekstin e lëndës së biologjisë për klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët	Kryetar/e	Naser Pajaziti
				Mentor/e	Begzad Baliu
				Anetar/e	Ruzhdi Kuqi
14	Florida Rexha	Mës. GJLSH	Ngarkesa leksikore në librin Gjeografia 7	Kryetar/e	Naser Pajaziti
				Mentor/e	Begzad Baliu
				Anetar/e	Tomorr Çela
15	Fitore Ahmeti	Mës. GJLSH	Roli i drejtorit në motivimin e nxënësve në përvetësimin e gjuhës shqipe në shkollat filllore të komunës së Kamenicës	Kryetar/e	Atdhe Hykolli
				Mentor/e	Begzad Baliu
				Anetar/e	Vlora Sylaj
16	Armir Krasniqi	Mës. Histori	Roli i lëndës së historisë në edukimin e nxënësve të hkollave të mesme të ulëta lidhur me diversitetin kulturor	Kryetar/e	Ethem Çeku
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Minevere Rashiti
17	Liridona Emini	Mës. Histori	Rëndësia e motivimi në përmirësimin e rezultatit në të nxënërit e lëndës së historisë në shkollën e mesme të ulët	Kryetar/e	Ethem Çeku
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Minevere Rashiti

Kandidati/ja: 1. Abetare Hajredinaj

Tema: Përshtatja e tekstit të matematikës për klasën e shtatë me rezultatet e të nxënit në kurrikulën lëndore për fushën e matematikës

ABSTRAKTI

Në Kosovë, Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar për herë të fundit është rishikuar në vitin 2016 dhe si e tillë ka hyrë në zbatim në vitin shkollor 2017-2018. Si tekst bazë për lëndën e matematikës-klasa e shtatë, në vitin 2019 është miratuar teksti "Matematika 7". Këto dy dokumente të rëndësishme për sistemin arsimor të vendit tonë, përdoren me vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit – MASHTI. Si të tilla duhet të kenë një përshtatje të madhe ndërmjet vete, gjegjësisht teksti i matematikës duhet të ketë përmbajtje që mundëson arrijtjen e rezultateve të të nxënit të lëndës për temë (RNL) që përcaktohen në kurrikulën lëndore. Prandaj, ky hulumtim ka për qëllim të analizojë përshtatjen e tekstit të matematikës për klasën e shtatë me rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL) të përcaktuara në kurrikulën lëndore për fushën e matematikës.

Për mbledhjen dhe analizën e të dhënave është adoptuar dhe përshtatur korniza teorike e cila mbështetet në metodën e analizës për kurrikulën e miratuar (Surveys of Enacted Curriculum - SEC) dhe pyetëtori për mësimdhënës i përshtatur sipas Standardeve për tekste shkollore (MASHT, 2011). Analiza e të dhënave, përfshin tre aspekte: analiza e stilit dhe strukturës së tekstit, analiza e përmbajtjes së tekstit dhe vlerësimi i tekstit nga mësimdhënësit.

Nga të gjeturat e këtij hulumtimi, del se shumë nga RNL-të e përcaktuara në kurrikulën lëndore nuk mund të arrihen përmes përmbajtjes së përfshirë në tekstin e matematikës për klasën e shtatë. Edhe mësimdhënësit pjesëmarrës në hulumtim, ndonëse e kanë vlerësuar si atraktive për nxënësit paraqitjen fizike të tekstit, konsiderojnë se ka mjaft boshllëqe sa i përket lidhjes së përmbajtjes së tekstit me RNL-të. Studimi tregon poashtu se ka disa mangësi edhe në hartimin e RNL-ve. Numri i madh i tyre dhe përfshirja e tyre në mënyrë të gabuar në disa tema, janë poashtu disa nga gjetjet që duhet të kenë vëmendje në proceset e rishikimit të vet kurrikulës.

Fjalët kyçe: Teksti i matematikës, kurrikula lëndore, rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)

Kandidati/ja: 2. Filloreta Berisha

Tema: Kurrikula Bërthamë dhe ndikimi i saj te mësimdhënësit e gjuhës shqipe në SHFMU

ABSTRAKTI

Pasiqë çdo ditë mësimdhënia bazohet në kurrikulë dhe kemi të bëjmë me të gjatë tërë kohës, kjo edhe është arsyeja pse duhet hulumtuar, pse jo edhe në detaje. Pra, në mësimdhënësit, bazohemi në kurrikulë për avancimin e fëmijëve tanë dhe të një mësimdhënie sa më të efektshme, andaj meriton një studim dhe hulumtim për të. Sigurisht gjithëherë duke u bazuar në literaturën e lexuar, duke u bazuar në përvojat e mësimdhënësve, në përvojat e nxënësve. Pra, qëllimi i këtij hulumtimi është që të vijmë në një përfundim se sa është i përshtatshëm për mësimdhënësit, sa është i efektshëm dhe më e rëndësishmja se si po ndikon kjo kurrikulë te mësimdhënësit.

Rezultatet e këtij hulumtimi janë produkte të ndërtuara nga analizimi dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura nga respondentet. Objekt i këtij hulumtimi janë shkollat fillore në vendbanime urbane dhe rurale. Të gjitha të dhënat për këtë hulumtim janë marrë përmes intervistimit të mësimdhënësve të gjuhës shqipe në SHFMU. Të gjeturat nga rishikimi i literaturës bashkëkohore dhe nga praktika edukativo-arsimore, janë pjesë përbërëse e këtij hulumtimi.

Ky hulumtim ka për synim të pasqyrojë se si po pritet Kurrikula Bërthamë nga arsimtarët e gjuhës shqipe në SHFMU, si po ndikon ajo dhe sa është efektive për mbarëvajtjen e mësimdhënies. Njëkohësisht, punimi do të shërbejë si udhërrëfyes për zhvillimin dhe ngritjen e mësimdhënies në Kosovë. Pasiqë me anë të këtij punimi do t'i shofim përparësitë dhe mangësitë e Kurrikulës Bërthamë.

Fjalët kyçe: *Bërthamë, Kurrikulë, Mësimdhënie, Nxënës.*

Kandidati/ja: 3. Melihate Dobra

Tema: Përdorimi i Google Forms për vlerësim tek nxënësit e klasës së dhjetë

ABSTRAKTI

Në këtë hulumtim shqyrtohet përdorimi i Google Forms në procesin mësimor për vlerësimin e nxënësve, pikëpamjet e mësimit dhe rezultatet e nxënësve në lidhje me vlerësimin me teste i organizuar nga mësimit dhe nxënësve të Gjymnazit “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu” në Drenas. Po ashtu, do të shqyrtohet edhe ndikimi i vlerësimit me Google Forms në suksesin e nxënësve të klasave të dhjeta.

Shfrytëzimi i teknologjisë informative është bërë i domosdoshëm, në institucionet arsimore gjatë kësaj periudhe të pandemisë, ku ju mundësohet mësimit dhe nxënësve qasja nga distanca në mënyrë virtuale.

Google Forms është një aplikacion i bazuar në internet që përdoret për të krijuar formular për qëllime të mbledhjes së të dhënave. Nxënësit dhe mësimit mund të përdorin Google Forms për të bërë pyetësor, kuize, ose fletë regjistrimi të ngjarjeve. Përdorimi i Google Forms mundëson vlerësimin e nxënësve edhe nga distanca.

Si metodologji për hulumtim është përdorur metoda e përzier, sasore dhe cilësore e cila mundëson përgjigjen në pyetjet e hulumtimit që lidhen me ndikimin e vlerësimit me Google Forms dhe në rezultatet e nxënësve. Për mbledhjen e të dhënave do të shfrytëzohen pyetësorët për mësimit dhe nxënësit.

Hulumtimi është realizuar në 2 klasë të dhjeta, të cilat janë në kuadër të shkollës - Gjymnazit “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu”. Nga rezultatet e fituara pritet të vërtetohet se vlerësimi me teste të vazhdueshme të krijuara me Google Forms ka ndikim në ndryshimin e suksesit të nxënësve dhe pikëpamjeve të mësimit për vlerësimin në përgjithësi dhe zhvillimin profesional të tyre.

Fjalë kyçe: Google Forms, testim, vlerësim, rezultate, motivim.

Kandidati/ja: 4. Fahri Tershani

Tema: Efektet e përdorimit të mësimit dixhital në motivimin e nxënësve dhe rezultatet e të nxënësve

ABSTRAKTI

Në ditët e sotme kur njohuritë dhe informacionet rrjedhin me shpejtësi, është i nevojshëm aplikimi i teknologjisë në procesin mësimor e sidomos aplikimi i mësimit dixhital, për të mbuluar shumë fusha dhe industri të ndryshme. Në procesin e mësimdhënies përdorim shumë metoda, teknika, simulime, të cilat paraqesin një rëndësi të veçantë në mësimdhënie dhe nxënie. Mësimdhënësit hartojnë shumë strategji të ndryshme të mësimdhënies për t'i përdorur këto në klasë dhe për të krijuar një klimë të të mësuarit të favorizuar për nxënësit, siç është përdorimi i mësimit dixhital, në mënyrë që nxënësit të ndihen të lirë të shtrojnë pyetje për diskutim, të rrisin pjesëmarrjen dhe t'i shfrytëzojnë këto mundësi me mësimdhënësit që sot ofron interneti. Mësimdhënësit duhet të promovojnë mësimin dixhital në klasë si një risi dhe alternativ e të mësuarit.

Prandaj, ky hulumtim shqyrton efektet e përdorimit të mësimit dixhital në motivimin e nxënësve dhe rezultatet e të nxënësve. Hartimi i aktiviteteve mësimore përmes përdorimit të mësimit dixhital dhe përdorimi fleksibël i mjeteve të teknologjisë janë çështjet kryesore për një arsimim më cilësor dhe të integruar.

Në këtë hulumtim është përdorur metoda kërkimore sasiore dhe cilësore dhe metoda e hulumtimit në veprim, me metodën kuazi eksperimental. Hulumtimi është zhvilluar në dy shkolla të mesme të ulëta të komunës së Shtimes, respektivisht në SHFMU “Emin Duraku” në Shtime dhe SHFMU “ Bajram Curri” në fshatin Petrovë. Mostrën e përbëjnë gjashtë klasë të nënta me 119 nxënës dhe 8 mësimdhënës të lëndëve të ndryshme, për nxënësit përgatiten dhe zhvillohet studimi i pyetësorëve, ndërsa për mësimdhënësit intervista, për të kuptuar mendimet e tyre rreth të mësuarit dixhital. Klasa IX-6 është zgjedhur si grup kontroll e cila është trajtuar me metodologjinë e mësimdhënies tradicionale, ndërsa klasa IX-5 është zgjedhur si grup eksperimental e cila i është nënshtuar trajtimit të përdorimit të mësimit dixhital.

Fjalët kyqe: *mësimdhënie, mësimnxënie, motivim i nxënësve, të mësuarit dixhital, rezultati i të nxënësve.*

Kandidati/ja: 5. Blerina Ibrahim

Tema: Përparësitë dhe mangësitë e e-mësimit në lënden e biologjisë në shkollën e mesme të ulët

ABSTRAKTI

Duke e ditur sa është pranuar teknologjia në botë si një urë lidhëse ndërmjet mësimdhënies drejtë të nxënit, dhe duke e analizuar sistemin arsimor në Kosovë, që deri tani nuk e ka përdorur e-mësimin, mirëpo si pasojë e Covid-19 ka filluar që të aplikoj atë, atëherë vie në përfundim që në Kosovë është duke u krijuar një histori e re në procesin edukativo-arsimor.

Për realizimin e hulumtimit është përdorur metoda kuantitative dhe kualitative. Qëllimi i hulumtimit është të shqyrtohen përparësitë dhe mangësitë e e-mësimit në lënden e biologjisë në SHMU.

Për të arritur deri te përparësitë dhe mangësitë e e-mësimit kam realizuar intervistë me 10 mësimdhënës të lëndes së biologjisë, në tri shkolla të mesme të ulëta dhe student të Fakultetit të Edukimit “Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Biologji”, të cilët janë të punësuar. Po ashtu kam realizuar edhe pyetësor që janë plotësuar nga nxënës të tri shkollave, një shkollë në mjedisin urban të Vushtrrisë “SHMU-2” ndërsa në mjedisin rural kanë marrur pjesë dy shkolla njëra në fshatin Mihaliq të Vushtrrisë “SHMU-Mihaliq”, dhe tjetra në fshatin Dobërllukë “Latif Berisha”. Gjithsej janë përfshirë 191 nxënës.

Në fund kam bërë analizimin e të dhënave të siguruar nga ana e intervistave dhe pyetësorëve, si dhe kam bërë krahasime dhe kam nxjerr përfundime. Rezultatet tregojnë se disa nga përparësitë e e-mësimit janë këto: fleksibiliteti, vizualizimi, më pak mungesa, ndërsa mangësi janë: vështërsia e qasjes nga disa nxënës, mungesa e ndërveprimit shoqëror. Nga ky hulumtim arrijë në konkludimi që mësimdhënësit dhe nxënësit janë në gjendje që të vazhdojnë përdorimin e e-mësimit mirëpo vetëm në bashkëpunim me mësimin e mbajtur në shkolla. E duke u bazuar në hulumtimet tjera të cilat janë bërë më herët në këtë aspekt të hulumtimit të e-mësimit në lënden e biologjisë, e-mësimi është shumë ndihmues sepse mund të bëjnë hulumtime të ndryshme në internet, të shohin njësitë mësimore të vizualizuara etj.

Fjalët kyqe: *e-mësimi, lënda e biologjisë, mangësitë, përparësitë, nxënësit.*

Kandidati/ja: 6. Yllka Emini

Tema: Efekti i menaxhimit të mësimit përmes platformës Schoology në mësimdhënie dhe mësimnxënie

ABSTRAKTI

Teknologjia është bërë një pjesë shumë e rëndësishme e procesit mësimor. Ajo po përdoret në arsim si një mjet për të mësuar, bashkëpunuar, për zhvillimin e kurrikulave dhe zhvillimin e stafit.

Kohëve të fundit në procesin e arsimit po përdoren sisteme të ndryshme të menaxhimit të mësimin (LMS) të cilat po u mundësojnë mësimdhënësve dhe nxënësve qasje në kurse të ndryshme në mënyrë virtuale nga distanca. Përdorimi i sistemeve të menaxhimit të mësimin (LMS) mundëson shërbime që ndihmojnë në menaxhimin e procesit mësimor, shkëmbimin e informacioneve në mes mësimdhënësve dhe nxënësve, krijimin e klasave dhe kurseve të ndryshme, krijimin e kuizeve të ndryshme online, vlerësimin, ruajtjen e të dhënave etj.

Ky hulumtim është fokusuar pikërisht në përdorimin e Schoology, si sistem i menaxhimit të mësimin online, se çfarë është, çfarë mundëson, çfarë efekti ka në menaxhimin e mësimin, si ndikon në bashkëveprimin mësimdhënës - nxënës, sa e rritë motivimin e nxënësve përdorimi i kësaj platforme për mësimin në distancë, çfarë ndikimi ka në arritjen e rezultateve të të nxënit etj.

Hulumtimi është realizuar me anë të metodologjisë sasimore dhe cilësore, ku si instrument matës është përdorur pyetësi për nxënës dhe intervista për mësimdhënës, që do të thotë se pjesë e hulumtimit kanë qenë gjithsej 124 respondentë, më saktësisht dy klasë me nga 30 nxënës të gjimnazit natyror “Xhavit Ahmeti” dhe dy klasë me nga 30 nxënës nga gjimnazi shoqëror “Zenel Hajdini” dhe 4 mësimdhënës nga këto dy shkolla të lartë përmendura. Pra, për mbledhjen e të dhënave kemi përdorur pyetësorët për nxënësit, për të parë se sa e përdorin nxënësit për mësimin platformën “Schoology” dhe si ka ndikuar përdorimi i saj në arritjen e rezultateve të të nxënit. Gjithashtu, janë realizuar intervistat për mësimdhënës, për të parë se çfarë efekti ka menaxhimi i mësimin në distancë përmes platformës “Schoology” si dhe a po i’u lehtësohet puna mësimdhënësve në procesin mësimor.

Nga ky hulumtim kemi nxjerrë rezultate pozitive për ndikimin e përdorimit të platformës Schoology në menaxhimin e mësimin nga distanca, dhe motivimin e nxënësve në arritjen e rezultateve duke përdorur platformën Schoology. Gjithashtu kemi bërë krahasimin e rezultateve të arritura nga të dy institucionet shkollore.

Këto rezultate do t’u shërbejnë mësimdhënësve të shkollave të cilët mendojnë të përdorin platforma elektronike në procesin e mësimdhënies.

Fjalët kyçe: *LMS, mësimdhënie, mësimnxënie, ndërveprim, platformë, Schoology.*

Kandidati/ja: 7. Vildane Sekiraqa

Tema: Analizë krahasuese e prezentimit të konceptit të funksionit në tekstet e vjetra dhe të reja të matematikës për klasat 6 dhe 7

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij studimi është krahasimi i përmbajtjeve me të cilat prezentohet koncepti i funksionit në tekstet e vjetra dhe të reja të matematikës për klasat 6 dhe 7. Si mostër shërbyen tekstet bazë dhe përmbledhjet e detyrave, të vjetrat dhe të rejat, për të dy klasat. Si metodë e hulumtimit është shfrytëzuar analiza vertikale e përmbajtjeve të teksteve shkollore. Korniza e analizës përbëhet prej dy pjesëve. Në njërën anë janë shqyrtuar karakteristikat strukturore të mbarështimit të njësisë dhe format e prezentimit të konceptit të funksionit. Në anën tjetër është adaptuar një kornizë analitike katër dimensionale për analizën e karakteristikave dhe natyrës së shembujve e detyrave të prezentuara në tekstet bazë dhe në përmbledhjet e detyrave. Dimensionet analitike të përdorura janë: kontekstet e pranishme në detyra, forma e prezentimit të detyrës, aktivitetet e nevojshme matematike për të zgjidhur detyrën dhe niveli kognitiv i detyrave. Të gjeturat e hulumtimit indikojnë se tekstet e reja të matematikës për klasat gjashtë dhe shtatë nuk kanë ndonjë zhvillim të theksuar apo përparim domethënës në paraqitjen e konceptit të funksionit. Mund të thuhet se tekstet e reja në masë të madhe i mimikërojnë tekstet e vjetra të dizajnuara para pothuajse njëzet vjetësh, dhe asesi nuk mund të thuhet se tekstet e reja janë dizajnuar duke pasur parasysh kërkesat e reja kurrikulare në Kosovë.

Fjalët kyçe: *Funksioni, tekstet shkollore, analizë, përmbajtje, detyra.*

Kandidati/ja: 8. Leonora Kadriu

Tema: Perceptimet e nxënësve për praktikat e vlerësimit në lëndën e kimisë

ABSTRAKTI

Reformimi i sistemit arsimor në Kosovë në vitet e fundit, ka ndryshuar dukshëm edhe metodologjinë e mësimdhënies e me këtë rast edhe metodologjinë e vlerësimit të nxënësit. Hulumtimi u zhvillua për të matur perceptimet e nxënësve në shkollat e mesme të ulëta në Kosovë, lidhur me praktikat e vlerësimit të cilat aplikohen gjatë procesit mësimor në lëndën e kimisë. Ky studim kishte për qëllim nxjerrjen e të dhënave mbi bazën e të cilave do të reflektohet mbi praktikat e vlerësimit të nxënësve në lëndën e kimisë në shkollën e mesme të ulët në Kosovë, nëse ato janë në harmoni me kërkesat e metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies dhe se sa u ofrohet nxënësve informacion kthyes e orientues për mësimnxënie produktive. Pyetjet kryesore në hulumtim ishin: Praktikrat e vlerësimit të nxënësve në lëndën e kimisë në shkollën e mesme të ulët në Kosovë, sa janë në harmoni me kërkesat e metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies? Praktikrat e vlerësimit të nxënësve në lëndën e kimisë në shkollën e mesme të ulët në Kosovë, sa ofrojnë informacion kthyes orientues për mësimnxënie produktive?; Vlerësimi i vazhdueshëm sa e nxitë të mësuarit tek nxënësit? Metodologjia e këtij hulumtimi është sasiore, ashtu që për mbledhjen e të dhënave sasiore u shfrytëzuan pyetësorët. Mostra e hulumtimit ngërthenë gjithsej 20 shkolla, ku u përfshin 516 nxënës. Përmes këtij hulumtimi ofrohet një pamje e përgjithshme për llojet e instrumenteve që përdoren për vlerësim të nxënësve në lëndën e kimisë, sipas këndvështrimit të nxënësve në shkollat e mesme të ulëta në Kosovë. Nga analiza dhe përpunimi i të dhënave të hulumtimit janë nxjerrë informacione bazë, se në shkollat tona procesi i vlerësimit të nxënësit sot është proces i vazhdueshëm dhe se praktikrat e vlerësimit të nxënësve në lëndën e kimisë janë në harmoni me kërkesat e mësimdhënies bashkëkohore.

Fjalët kyçe: *kimi, nxënës, perceptim, vlerësim.*

Kandidati/ja: 9. Bjondina Zejnullahu

Tema: Puna në grupe në funksion të motivimit të nxënësve për të nxënit e lëndës së Historisë në shkollat e mesme të ulta

ABSTRAKTI

Në konceptin modern të mësimdhënies dhe mësimnxënies rëndësi të veçantë po kanë metodat dhe teknikat e punës. Ky koncept ka ndryshuar nga mësimdhënësi në qendër të vëmëndjes, duke kaluar tek nxënësi, i cili është fokusi kryesor dhe në këtë rast mësimdhënësi është lokomotika kryesore që e orjeton atë drejtë të nxënit efektiv. Qëllimi i këtij punimi është analiza e njëra prej metodave më përdorura në arsimin modern, pra puna në grupe në përgjithësi në procesin e mësimdhënies dhe në veçanti impakti që kanë në lëndën e historisë..

Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur metoda mikse, pra ajo kualitative dhe kuantitative. Gjithashtu, edhe metoda e analizës teorike me programin SPSS si dhe metoda përshkruese që janë shfrytëzuar në hulumtim. Instrumentet që u përdorën në hulumtim janë: pyetësorët për nxënës dhe mësimdhënës dhe intervistat gjysmë të strukturuar. Në hulumtim janë përfshirë 200 nxënës dhe 100 mësimdhënës të dy shkollave nga komuna e Gjilanit SH.F.M.U “Selami Hallaçi” dhe “Thimi Mitko” të lëndëve të ndryshme në këto dy shkolla. Moshë e mësimdhënësve ka qenë e ndryshme 54% e mësimdhënës i takojnë moshës 30-40 vjeç, 37% i takojnë moshës 40-50 vjeç dhe 9% i takojnë moshës 50-60 vjeç., ndërsa e nxënësve 12-15 vite.

Të dhënat e dalta nga ky hulumtim, do të ndikojnë fillimisht në informimin lidhur me rëndësinë që i japin mësimdhënësit e historisë punës në grupe dhe impakti që ka kjo metodë në arritjen e rezultateve më të larta në lëndën e Historisë. Nga studimi që është kryer arrijmë në përfundim, se puna në grupe jo vetëm ndikon në socializimin e nxënësve, në zhvillimin e mendimit kritik dhe kreativ por gjithashtu zhvillon komunikimin dhe shkathtësit ndërvepruese tek nxënësit, e gjitha këto janë kërkësa që burojnë nga Kurrikula e re e Kosovës. Gjithashtu faktori tjetër me rëndësi janë rekomandimet që do të dalin nga ky studim dhe që mund të merren nga shkollat dhe institucionet arsimore për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënit.

Fjalët kyçe: motivim, ndikim, grup, histori.

Kandidati/ja: 10. Elfete Shurdhaj

Tema: Përdorimi i Teknologjisë asistive (ndihmëse) te femijët me nevoja të veçanta në shkencat Matematiko-Natyrore

ABSTRAKTI

Përdorimi i teknologjisë asistive (ndihmëse) në procesin mësimor luan një rol të rëndësishëm tek nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Nëpërmjet këtij punimi synohet të tregohet puna e mësimdhënësit, metodat dhe strategjitë e mësimdhënies, që mësimdhënësi përdor gjatë orës mësimore për nxënësit me nevoja të veçanta në shkencat Matematiko-Natyrore. Pajisjet ndihmëse informative janë produkte harduerike ose softuerike që u mundësojnë personave me aftësi të kufizuara qasje, interakcion dhe përdorimin e kompjuterëve në shtëpi, në shkollë apo në punë.

Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë për të treguar se me përdorimin e pajisjeve asistive (ndihmëse) gjatë procesit mësimorë rriten aftësit e nxënësit në shkencat Matematiko-Natyror. Të dhënat prej hulumtimit tregojnë se përdorimi i pajisjeve asistive (ndihmëse) në procesin mësimor rrit interesimin e nxënësve për të nxënë dhe shkathtësi tjera shkollore. Përdorimi i teknologjisë ndihmëse në mësim mund të jetë shumë i dobishëm si vegël e cila do ta përkrahë procesin e përcjelljes së mësimin, pjesëmarrjes gjatë orës së mësimin, si dhe mundësi për përcjellje dhe evaluim të arriturave të nxënësit.

Metodologjia e përdorur në këtë hulumtim janë metodat sasiore dhe cilësore, ku me anë të këtyre metodave është menduar të arrihet testimi i hipotezës. Në fazën e parë është përdorur metoda sasiore, të dhënat parësore janë mbledhur duke përdorur instrumente matëse si pyetësorët me mësimdhënësit në lidhje me përdorimin e pajisjeve asistive (ndihmëse) tek nxënësit me nevoja të veçanta në shkencat matematiko-natyrore. Kurse në fazën e dytë është përdorur metoda cilësore, ku të dhënat dytësore janë mbledhë duke shfrytëzuar literaturë të ndryshme të huaja dhe vendore si dhe burime nga internet në lidhje me temën për pajisjet asistive (ndihmëse) dhe përdorimin e tyre. Hulumtimi është realizuar në disa shkolla fillore të mesme të ulëta në Komunën e Malishevës dhe Komunën e Suharekës. Pjesëmarrës për realizimin e këtij hulumtimi kanë qenë: 150-të mësimdhënësit nga 24-të shkolla si dhe numri I nxënësve në këto shkolla ka qenë 46-të të klasave të VI-IX-të.

Hulumtimi do t'ju ofrojë informata dhe shembuj nga përdorimi praktikë i kompjuterit dhe teknologjisë ndihmëse gjatë punës me nxënës me nevoja të veçanta arsimore.

Fjalët kyçe: mësimdhënësit, nxënës, trajtim, shkollë, përdorimi i pajisjeve asistive (ndihmëse).

Kandidati/ja: 11. Albanina Ramaj

Tema: Ndikimi i metodës bashkëbiseduese në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore nga biologjia

ABSTRAKTI

Kur kemi të bëjmë me termin Mësimëdhënie atëherë duhet mësuar dhe analizuar të gjitha ato çka e bëjnë një mësimdhënës të suksesshëm dhe të aftë për të mbajtur procesin mësimor. Asnjë nga nxënësit nuk është i njëjtë ashtu sikurse nuk është e njëjtë asnjë orë mësimore dhe asnjë lëndë mësimore. Ka shumë metoda dhe teknika që e bëjnë të veçantë një orë mësimore.

Ky hulumtim është realizuar në bazë të metodës kualitative dhe kuantitative. Gjatë realizimit të hulumtimit, kam monitoruar realizimin e disa orëve mësimore, kam analizuar ecurinë e zhvillimit të bisedës, nxitjen e nxënësve nga ana e arsimtarit për bashkëbisedim, sa arsimtari e orienton bisedën drejt problemit, si dhe sa arrin ai të krijoj situatën mësimore për shprehjen lirshëm të mendimeve nga ana e nxënësit.

Duke u bazuar në këtë, kam realizuar intervistë me 6 mësimdhënës, 3 mësimdhënës të SHML-Gjimnazi “Bedri Pejani “ dhe 3 mësimdhënës të SHML të Mjekësisë në qytetin e Pejës. Poashtu, kam realizuar edhe pyetësor, të cilët janë plotësuar nga nxënësit e këtyre dy shkollave. Nxënësit kanë qenë nxënës të klasave X dhe XI. Gjithsej janë përfshirë 180 nxënës.

Në fund kam analizuar të dhënat e mbledhura me anë të instrumenteve, dhe kam nxjerrë përfundime. Rezultatet tregojnë se si përparësi e kësaj metode për dallim nga metodat e tjera mësimore, është ndikimi i shumëanshëm pozitiv, duke përfshirë qasjen më të lehtë të nxënësve në shprehjen e lirë të mendimeve, diskutime dhe ndërlidhje mes njohurive nga jeta personale me informacionet e reja mësimore, koha dhe hapësira e duhur për këmbim të informacioneve mes nxënësve si dhe mësim nga njëri-tjetri etj, e që kjo metodë si mangësi të cekur në pothuajse secilin rast ka kalimin në pasivitet të një numri të vogël nxënësish brenda klases. Nga ky hulumtim arrijë në konkludim se si për nxënësit ashtu dhe mësimdhënësit, me përdorimin e bashkëbisedimit si metodë, niveli i përvetësimit të njohurive do të jetë në shkallë të lartë.

Fjalët kyqe: bashkëbisedim, metodë, mësimdhënie, përvetësim, përmbajtje.

Kandidati/ja: 12. Behare Gashi-Shala

Tema: **Mjetet e komunikimit në gjuhë, letërsi, kulturë, folklor dhe art**

ABSTRAKTI

Në këtë punim do të trajtohet çështja e komunikimit në gjuhë, letërsi, kulturë, folklor dhe art. Ky hulumtim bëhet për të parë se sa i rëndësishëm apo më mire të themi i domosdoshëm është për njeriun dhe deri në ç'skallë ka arritur komunikimi prej kohës së lashtë deri në ditët e sotme. Mjetet e komunikimit në gjuhë, letërsi, kulturë, folklor dhe art janë objekt i studimit tonë. Do të hulumtoj literaturë të shumtë për të parë se cilat kanë qenë mjetet e komunikimit përmes këtyre që nga kohët e lashta e deri në ditët e sotme. Shpresojmë që përmes këtij hulumtimi të paraqesim rrjedhën e komunikimit ndër kohë dhe mjetet që kanë përdorur për komunikim dhe sa kanë qenë të rëndësishme për qeniet njerëzore.

Pra do të grumbullohet literaturë e shkrimtarëve të ndryshëm dhe gjatë punimit të kësaj teme do të paraqesim rrjedhën e gjuhës nëpër etapa të ndryshme, se si njerëzit kanë komunikuar në gjuhë, letërsi, kulturë, folklor dhe art dhe çfarë mjetesh komunikimi kanë përdorur.

Metodat të cilat do të përdorim në këtë punim janë grumbullimi dhe analizat që do të ju referohemi librave të shkrimtarëve të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj të vendeve të ndryshme për të parë rrjedhën e komunikimit nëpër kohë.

Proceset e hulumtimit do të kryhen në grumbullimin e literaturës së ndryshme të shkrimtarëve të ndryshëm.

Identifikimi i problemeve të komunikimit që nga kohët e lashta e deri më sot do të na ndihmojë të gjejmë edhe rrugën se si ka filluar dhe si është zhvilluar komunikimi, sa ka qenë i domosdoshëm dhe çfarë mjetesh komunikimi kanë përdorur njerëzit në gjuhë, letërsi, kulturë, folklor dhe art.

Fjalët kyçe: komunikim, mjete, folklor, art, kulturë.

Kandidati/ja: 13. Skender Asllani

Tema: Fusha leksikore dhe mbingarkesa gjuhësore në tekstin e lëndës së biologjisë për klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët

ABSTRAKTI

Objekt i studimit me temë *Fusha leksikore dhe mbingarkesa gjuhësore në tekstin e lëndës së biologjisë për klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët*, do ta paraqes në aspektin e identifikimit të problemeve dhe vështirësitë që hasin nxënësit tanë në përdorimin dhe formulimin e fjalëve të huaja të panevojshme, sepse për to gjuha shqipe ka fjalët e saja shumë kuptimplota. Po ashtu gjatë punimit të kësaj teme do të shikojmë, njëkohësisht, edhe drejtshkrimin dhe formulimin e fjalive se *a* janë në pajtim më normën e shqipes standarde dhe strukturën e fjalisë së saj.

Siç dihet mbingarkesa leksikore dhe përdorimi i fjalëve të huaja paraqet te nxënësit dy probleme thelbësore: Në radhë të parë krijon vështirësinë në të nxënit e procesit mësimor dhe në kuptimin e analizës së saj; Në radhë të dytë te nxënësit (po ashtu edhe në shoqëri të përgjithshme) do të krijohen shkathtësi, pastaj shprehi në përdorimin e shprehjeve të përdorimit të fjalëve të huaja të panevojshme, duke i lënë jashtë përdorimit fjalët e gjuhës shqipe, kur dihet mirëfilli se shqipja i ka shprehjet dhe fjalët e bukura të saj.

Prandaj, me anë të këtij punimi do të bëjmë përpjekje që të nxjerrim në pah këto të meta dhe mbingarkesën që ka teksti i klasës së shtatë i lëndës së biologjisë, i cili është botuar vitin e kaluar me pëlqimin dhe miratimin e Ministrisë së Arsimit. Natyrisht, të gjitha të metat, kuptohet do të jenë me të dhëna dhe me shembuj konkretë, pastaj duke i paraqitur edhe me anë të referencave.

Fjalët kyçe: Vështirësi, mbingarkesë, paqartësi, rezultate, vlerësim, dallim, latinisht, nxënës, mësimdhënës.

Kandidati/ja: 14. Florida Rexha

Tema: Ngarkesa leksikore në librin Gjeografia 7

ABSTRAKTI

Objekt i studimit me temë: Fusha leksikore dhe ngarkesa e teksteve të lëndës së gjeografisë për klasat e shtata do të paraqitet në aspektin e identifikimit të problemeve dhe gabime që në mënyrë institucionale që po u afrohet nxënësve tanë. Kjo dukuri shqetësuese dhe e pakontrolluar është shkaktari kyç, në të mësuarit e lëndës dhe njëkohësisht krijon vështirësi në kuptimin dhe analizën e mësimit të organizuar nëpër shkolla fillore.

Fjalët e përdorura e që janë të panevojshme apo që mund t'i zëvendësojmë me fjalë të bukura shqipe e që do të ishte shumë më mirë për nxënësit dhe të gjithë akterët tjerë të shoqërisë në përgjithësi, andaj hulumtimi i kësaj teme po shpresojmë që sadopak do të nxjerr në pah të metat e teksteve shkollore. Punimi do t'i paraqesë të gjitha të metat dhe ngarkesën që ka teksti i klasës së shtatë, kuptohet me të dhëna, me shembuj konkretë dhe referenca. Jam në bashkëkoordinim me mentorin si dhe mësuesin me përvojë të lëndës së gjeografisë, me të cilët i bashkërendoj punët rreth punimit.

Fjalët kyçe: *biologjia, mjedisi, termat, nocionet, ngarkesa leksikore*

Kandidati/ja: 15. Fitore Ahmeti

Tema: Roli i drejtorit në motivimin e nxënësve në përvetësimin e gjuhës shqipe në shkollat fillore të komunës së Kamenicës

ABSTRAKTI

Objekt i kërkimit tonë është *roli i drejtorit në motivimin e nxënësve në përvetësimin e gjuhës shqipe në shkollat fillore të komunës së Kamenicës*. Mësimi i gjuhës amtare në shkollën tonë, është shoqëruar nga përpjekje të vazhdueshme për ndryshimin e programeve mësimore dhe të teksteve, duke i riparë, rikonceptuar, ristrukturuar dhe përmirësuar ato. Në këtë punim do të shqyrtojmë metodat e udhëheqjes së drejtorit drejt mësimin të gjuhës shqipe të cilat janë të ilustruara përgjithësisht me shembuj nëpër klasa, tipat e orëve mësimore për lëndën e gjuhës shqipe dhe problemet e të nxënësve në mësimin e gjuhës shqipe duke i dhënë drejtimin e punës së udhëheqësit të shkollës (drejtorit). Mësimi i gjuhës shqipe në shkollat tona, si një nga lëndët bazë për formimin dhe edukimin e nxënësve ka pësuar ndryshime të thella si në qëllimet e përmbajtjes së vet, në format e organizimit të procesit mësimor ashtu edhe në metodat e dhënies së njohurive të formimit të shkathtësive dhe të shprehive. Mësuesi i gjuhës shqipe, për t'ia arritur qëllimit që nxënësit të përvetësojnë lëndën dhe të zotërojnë atë, zgjedh rrugën më të mirë, më të drejtë, më të përshtatshme dhe për të zgjedhur njërin ose tjetrën metodë duhet të udhëhiqet nga disa kritere. Objekt i studimit në punimin tim është edhe motivimi i drejtorit drejt nxënësve për mësimin e gjuhës shqipe, ligjërimi i mirë i gjuhës shqipe dhe ndikimin e saj në performancën e drejtorit, bashkëpunimi i drejtorit me mësuesin e gjuhës shqipe për organizimin e recitaleve për festat e ndryshme, publikimin e gazetës së murit me punime nga nxënësit si ese, vjersha, tregime etj. organizimin e shfaqjeve teatrale, ku si hulumtim janë përdorur katër shkolla fillore në Komunën e Kamenicës.

Fjalët kyçe: drejtori, mësuesi, motivimi, nxënësit, suksesi, gjuha shqipe

Kandidati/ja: 16. Armir Krasniqi

Tema: Roli i lëndës së historisë në edukimin e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta lidhur me diversitetin kulturor

ABSTRAKTI

Në institucionet edukativo-arsimore, lënda e historisë dhe të nxënësve e saj zë një rol të rëndësishëm në edukimin e nxënësve. Në këtë kontekst, edukimi i nxënësve në frymën për diversitet kulturor është jashtëzakonisht i rëndësishëm po aq sa edhe jetik në formësimin e kushteve për një mjedis sa më socio-human, demokratik, tolerant e me sa më pak konflikte kulturore, elemente këto që favorizojnë një stabilitet të përgjithshëm shoqëror dhe që në aspektin gjeografik gëzojnë një përkrahje në nivel të gjerë global.

Qëllimi i këtij punimi është që të hulumtoj dhe analizoj rolin që ka lënda e historisë në edukimin e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta lidhur me diversitetin kulturor.

Për realizimin e këtij hulumtimi, janë përdorur metoda mikse ajo kualitative dhe kuantitative, përveç këtyre metodave mikse është përfshirë edhe shfrytëzimi i literaturës relevante që ka të bëjë me temën. Instrumentet që janë përdorur në këtë hulumtim, janë: pyetësori (i strukturuar) dhe intervista (gjysmë e strukturuar).

Në këtë hulumtim janë përfshirë 192 respondentë. Prej tyre janë 7 mësuesdhënës/e të historisë dhe 185 nxënës të shkollave të mesme të ulëta. Mosha e mësuesdhënësve është e ndryshme, ndërsa mosha e nxënësve varion nga 13-15 vjeç.

Hulumtimi është realizuar në këto komuna: Prizren dhe Suharekë. Ndërsa shkollat që kanë qenë pjesë në këtë hulumtim, në bazë të vendbanimit, janë: dy shkolla nga zona urbane dhe dy shkolla nga zona rurale prej secilës komunë të cekur më lart.

Të dhënat e dalta nga ky hulumtim do të ndikojnë në sensibilizimin e mësuesdhënësve të historisë si dhe të opinionit të gjerë duke ndriquar faktin se çfarë roli ka lënda e historisë në edukimin e nxënësve lidhur me diversitetin kulturor.

Fjalët kyçe: *diversiteti kulturor, edukimi, historia, mësuesdhënësit, nxënësit.*

Kandidati/ja: 17. Liridona Emini

Tema: Rëndësia e motivimi në përmirësimin e rezultatit në të nxënit e lëndës së historisë në shkollën e mesme të ulët

ABSTRAKTI

Në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit në lëndën e Historisë, rol të jashtëzakonshëm ka motivimi. Duke e ditur rëndësinë e tij, motivimi përfaqëson pjesën më të rëndësishme në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies në përmirësimin e rezultateve në lëndën e Historisë. Çdo aktivitet është i kushtëzuar nga motivimi i individit. Motivimi është impuls i cili cakton, mban, dhe synon sjelljen e njeriut. Motivimi përcaktohet nga forcat që veprojnë mbi ose brenda një personi dhe që e detyrojnë atë të sillet në një mënyrë të caktuar, të orientuar nga disa qëllime. Prandaj, qëllimi i këtij punimi është që të hulumtoj edhe analizoj burimet kryesore të cilat ndikojnë në motivimin e nxënësve në lëndën e Historisë si dhe sa ndikon motivimi në përmirësimin e rezultateve të të nxënit në lëndën e Historisë.

Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur metoda mikse, pra ajo kualitative dhe kuantitative. Gjithashtu, edhe metoda e analizës teorike me programin SPSS si dhe metoda përshkruese që janë shfrytëzuar në hulumtim. Instrumentet që u përdorën në hulumtim janë: pyetësorët për nxënës dhe mësimdhënës dhe intervistat gjysmë të strukturuar. Në hulumtim janë përfshirë 200 respondent, prej tyre 14 mësimdhënës dhe 186 nxënës. Moshë e mësimdhënësve ka qenë e ndryshme, ndërsa e nxënësve 12-15 vite.

Të dhënat e dala nga ky hulumtim, do të ndikojnë në informimin dhe sensibilizimin e mësimdhënësve lidhur me rëndësinë e motivimit në përmirësimin e rezultateve në të nxënit në lëndën e Historisë. Nga studimi që është kryer arrijmë në përfundim, se motivimi është faktor i rëndësishëm i jetës shkollore dhe se rëndësia e motivimit është shumë e madhe në përmirësimin e rezultateve në lëndën e Historisë. Gjithashtu faktori tjetër me rëndësi është edhe mënyra se si mësimdhënësi e organizon orën mësimore, metodat, teknikat, strategjitë që i përdor mësimdhënësi për të stimuluar dhe për të nxitur nxënësit në mësimnxënie.

Fjalët kyçe: *motivim, mësimdhënie, mësimnxënie, SHMU, histori.*